



Nr. 141/10 Prot
27.12.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 706/Prot.

Tiranë, më 27.12.2022

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Nr. 954, datë 27.12.2022

PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË “ALBAFILM” SH.A TIRANË

Në mbështetje të ligjit nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 09.09.2020 “Për transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë “Albafilm” sh.a, Tiranë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Ministria e Kulturës”, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të Statutit të shoqërisë “Albafilm” sh.a, si dhe vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 5879/4, datë 07.12.2022 “Për emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar për përgatitjen e raportit për pasuritë “Ish-Zdruktharia dhe sipërfaqe funksionale, të shoqërisë ‘Albafilm’ sha. Tiranë”,

VENDOSI:

1. Kapital themeltar të zvogëlohet për vlerën 37,102,000 (tridhjetë e shtatë milion e njëqind e dy mijë) lekë, i barabartë me 37,102 (tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e dy) aksione, me vlerë nominale 1,000 (njëmijë) lekë.
 2. Kapitali aksionar i shoqërisë ishte 884,876,000 (tetëqind e tetëdhjetë e katër milion e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë bëhet 847,774,000 (tetëqind e dyzet e shtatë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë) lekë.
 3. Numri i aksioneve ishte 884,876 (tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) aksione, bëhet 847,774 (tetëqind e dyzet e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër) aksione.
 4. Kapitali i shlyer ishte 884,876,000 (tetëqind e tetëdhjetë e katër milion e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, bëhet 847,774,000 (tetëqind e dyzet e shtatë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë) lekë.
 5. Ngarkohen Administratori i shoqërisë “Albafilm” sha, Tiranë për njoftimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit për zvogëlimin e kapitalit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
Elva Margariti

